



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Prishtinë, 25 qershor 2008, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**i dëgjimit publik të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për Ligjin e Punës**

Nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina, Armend Zemaj, Teuta Hadri, Mimoza Ahmetaj

Munguan: Sllobodan Petroviq dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm: nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj-administratore, Drita Morina-zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri-zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta-nëpunëse administrative.

Të ftuar :

Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Shërbimeve Publike, Sindikata për Punë Sociale Ndërkombëtare në Kosovë, Oda Ekonomike Amerikane, Oda Ekonomike e Kosovës, Sindikata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Konfederata e Sindikatave të Lira të Kosovës, Shoqata e Bankave në Kosovë, Aleanca Kosovare e Biznesit, Shoqata e Mjekësisë së Punës të Kosovës, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Instituti Riinvest, Gratë për Gratë Internacionale, Federata Sindikale e Shëndetësisë, Posta dhe Telekomit i Kosovës, World Bank Kosovo, Hekurudhat e Kosovës, IPKO NET, Raiffeisen Bank, Pro Credit Bank, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, UNDP, USAID, Zylfie Hundozi-Raportuese ne mandatin e kaluar për Projektligjin e Punës, Hava Bujupi- Ismajli,- Eksperte.

Dëgjimin publik e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

**Sadik Idriz**– Hapi debatin publik lidhur me Projektligjin për punën. Ai njoftoi të pranishmit të cilët nuk kuptojnë serbisht mund të marrin dëgjueset për përkthim. Pasi përshëndeti të pranishmit ai tha se Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale ka filluar me shqyrtimin e Projektligjit për punën i cili ka kaluar leximin e parë në Kuvendin e Kosovës, ligj i cili është i domosdoshëm për Kosovën. Shumë vite pas luftës Kosova nuk ka një ligj për punën. Kanë ekzistuar disa rregullore në bazë të të cilave është punuar. Ky projektligj është punuar në mandatin e kaluar por nuk është miratuar pasi ka pasur disa pengesa. Gjithashtu në mandatin e kaluar është organizuar një debat publik për këtë ligj dhe kanë qenë të angazhuar ekspert të ndryshëm. Komisioni deri më tani ka pasur disa aktivitete lidhur me këtë

Projektligj, ka formuar grupin punues i cili do të merret me amendamentet, është mbajtur edhe takimi me përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shërbimeve Publike, kanë qenë të ftuar edhe përfaqësuesit e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa por të cilët nuk iu janë përgjigjur ftesës për takim. Interesimi për këtë projektligj është shumë i madh nga të gjitha organizatat. Ky Projektligj ka një bazë, por ka dilema të shumta të cilat ai pret se do të zgjidhen. Dilema e parë është për kënd punohet ky ligj, cilat janë kategoritë e punëtorëve të përfshira me këtë ligj. Sipas memorandumit shpjegues nga Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, ky ligj përfshinë edhe arsimin edhe shëndetësinë, por kjo mund të lexohet vetëm në memorandum shpjegues. Gjithashtu shkruan se do të jetë një ligj i ri për shërbyesit civil, nëse do të jetë pse nuk mund të jetë pjesë e këtij ligji? Pra, ekzistojnë shumë dilema dhe Komisioni dëshiron t'i zgjedh që të bëjë një ligj sa më të mirë. Dilema e dytë është se ky ligj ka implikime buxhetore, të cilat implikime do të jenë edhe më të mëdha kur të përfshihen të gjithë punëtorët. Qeveria e ka miratuar këtë ligj gjithashtu edhe Kuvendi e ka miratuar në leximin e parë.

Hap debatin. Ai ju kujtoi të pranishmëve se e tyre për diskutim është e kufizuar në pesë minuta, pasi që propozimet dhe vërejtjet konkrete të pranishmit duhet t'i dorëzojnë me shkrim e të cilat pastaj Komisioni do t'i shqyrtoi gjatë shqyrtimit të Projektligjit.

**Behxhet Gaxhiqi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**-Tha se nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në të gjitha konferencat që ka pasur deri më sot si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij, si dhe në konferencën e fundit të ILOS në Gjenevë, është kërkuar nga secili shtet i jashtëm që të ketë ligjin e punës. Ligji i punës është me vlerë të madhe për shtetin e Kosovës. Pa këtë ligj në radhë të parë nuk mund të realizohen kontakte bilaterale me shtetet e huaja për punëtorët. Është e qartë se në këtë projekt nuk janë përfshirë të gjitha pikat e rëndësishme por meqë është organizuar ky takim ai beson se mund dilet me konkluzat konkrete. Po ashtu ai tha se janë të vetëdijshëm se ky Projektligj ka implikime buxhetore, por do të shikojnë se në çfarë forme do të lëvizin në mënyrë që ato lëvizje të jenë të arsyeshme që, mos të cungohet vija buxhetore që është jetike por të shkojnë në një vijë buxhetore që është më e lehtë për tu realizuar.

**Gjylnaze Syla**- Tha se ka dy pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale: Çfarë efekti ekonomik do të ketë ky ligj dhe cilat kategori të punëtorëve përfshihen më këtë ligj?

**Gjylnaze Novobërdaliu-Gola**-Tha se Rregullorja 2001/27 është në implementim. Kjo rregullore ka shumë mangësi. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka zvogëluar këtë ligj në 104 nene pikërisht për shkak të implikimeve buxhetore.

**Rita Hajzeraj**- Tha se në mbledhjen e fundit Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale ka pasur të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Dilema lidhur me këtë ligj është se përfshihen vetëm sektori privat dhe publik, tani ajo tha se ka kuptuar që implikimet buxhetore janë arsye për këtë kategorizim. Pyetja e saj ishte pse më këtë Projektligj janë përfshirë edhe sektori i punëtorëve të shëndetësisë dhe të arsimit? Statusi i këtyre kategorive nuk është rregulluar koma dhe ata trajtohen si shërbyes civil.

**Edgardo Roggier nga Fondi Monetar Ndërkombëtar**- Tha se në prill ka diskutuar me Qeverinë për Projektligjin dhe kanë gjetur shumë probleme nga pikëpamja ekonomike dhe fiskale. Ata ishin pajtuar me Qeverinë që të tërhiqet ky Projektligj për tu kompletuar. Ky ligj duhet të mbrojtë të drejtat e punëtorëve në fakt krijon shumë infleksibilitet në tregun e punës

dhe krijon mundësi më të pakta të punësimit. MEF është Ministri e Ekonomisë dhe Financave dhe ata duhet të analizojnë implikimet ekonomike dhe fiskale. Implikimet ekonomike domethënë se ky ligj ofron mundësi më të pakta të punësimit dhe implikimet financiare domethënë sa do të kushtoi shumë para. Ky ligj pastaj do të krijoj pengesa për të punësuar gratë. Ai ishte i mendimit se fundamentalisht ky ligj duhet të ri ekzaminohet, sepse do të ketë ndikim negativ në rritjen e ekonomisë.

**Diturie Hoxha nga Shoqata e Bankave të Kosovës-** Tha se komentet e përgjithshme lidhur me këtë Projektligj i kanë dorëzuar me shkrim. Ajo tha se klientët e tyre janë ata që i krijojnë vendet e punës sot dhe ata kanë parë të arsyeshme që ligjin ta shohin me syrin e klientit, sot ajo flet në emër të tyre. Sipas saj ky Projektligj është jo fleksibil dhe lënë shumë hapësirë për punëtorët, kjo në pikëpamje ekonomike do të ndikoi në rënien e punësimit.

**Xhevat Shkodra nga Shoqatat e Mjekëve të Mjekësisë së Punës të Kosovës-** Tha se ligji i punës është mese i domosdoshëm për Kosovën. Ai tha se shoqata e tyre ka vlerësuar se na duhet një ligj jo i një sektori, por një ligj i të gjithë sektorëve dhe çdo anashkalim paraqet neglizhim të një pjese të punëtorëve. Ky projektligj është një formë e mirë e rregullimit të raporteve në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, por normalisht gjithmonë ka hapësirë për përsosjen e tij. Ai propozoi që Komisioni të marrë për bazë riorganizimin e mjekësisë së punës e cila ka me qenë bartëse e mbrojtjes së shëndetit të punëtorëve në punë. Ai do të dorëzoi me shkrim propozimet- vërejtjet konkrete.

**Haxhi Gashi përfaqësues i USAID-** Tha se do të prezantoi disa pika që janë qenësore pa zgjedhjen e të cilave nuk mund të kalohet në shqyrtimin përmbajtjesor të ligjit, ndërsa propozimet konkrete do t'i dorëzoi me shkrim. Ligji ka disa probleme konceptuale në marrëdhënien e punës. Pa e zgjidhur nenin 1 nuk mund të kalohet në nenet e tjera. Ky nen ka bërë një kategorizim të punëtorëve por nuk e ka zgjidhur problemin si: a do të përfshihen arsimit dhe shëndetësia në këtë ligj. Në memorandumun shpjegues thuhet se këto kategori do të rregullohen me ligj të veçantë në anën tjetër del se kjo kategori është përfshirë me ligj. Problemi i dytë është se në ligj nuk është sqaruar marrëdhëniet e punës të kategorisë së shërbyesve publik, a janë përfshirë në këtë ligj a jo nga kjo pastaj rezultojnë të gjitha implikimet dhe marrëdhëniet e punës. Implikimet buxhetore janë shumë serioze, mund të bëhet një ligj por nëse nuk mund të zbatohet në praktikë atëherë për këndë është bërë ai ligj . Ai tha se 560 000 euro janë shpenzime që dalin nga ligji por nuk janë të planifikuara. Shuma e përgjithshme e ligjit është 14 743 000 euro të cilat pritet të planifikohen për buxhetin e ardhshëm. Askush nuk ka të drejtë që pasi të miratohet ligji të thotë se nuk kemi mjete për të paguar atë që është e parashikuar me ligj sepse qytetari e realizon të drejtën e parashikuar me ligj kur të miratohet ligji dhe as punëdhënësi nuk ka të drejtë të thotë se nuk ka mjete për të paguar . Duhet të miratohet një ligj që mund të zbatohet. Ligji për punën është ligj i cili drejtpërsëdrejti prek ekonominë e Kosovës . Sipas rregullores së punës së Qeverisë secili ligj duhet të ketë një memorandum shpjegues për efektet ekonomike. Me këtë ligj krijohen mundësi për hapjen e vendeve të punës ose kufizimin e saj. Ai nuk me këtë nuk propozon të bëhet një kartë e të drejtave të punëtorëve, por duhet të bëhet një ligj për marrëdhënien e punës duke siguruar ambient të mirë dhe të shëndoshë për punën. Nëse me këtë ligj nuk krijohen vende të punës, atëherë të drejtat e kujt po rregullohen me këtë ligj.

**Riza Smaka-**Tha se ka shumë vërejtje të përgjithshme edhe praktike . Njëjësi duhet të përdoret në tërë tekstin e ligjit. Nuk thuhet shqiptohet vendimi, por miratohet. Ai tha se nevojitet një ligj për punë i karakterit sistemor që do të rregullonte të gjitha institutet juridike punësore. Për të bërë një ligj të mirë duhet apriori të hiqet implikacioni financiar. Duhet të

konstatohet saktë se femrës e cila lind i takojnë kaq muaj dhe nëse bindemi që i takojnë 6 muaj le t'i takojnë edhe le të kushtoi sa të kushtoi. Ky ligj nuk përputhet në të tri gjuhët ky duhet të jetë unik si në shqip si në versionet e tjera. Në këtë ligj pala herë dërgohet në gjykata të kompetencës së përgjithshme e herë në Gjykatën Supreme në konflikt administrativ. Kontrata e punës nuk është akt administrativ për tu drejtuar pala në gjykatën Supreme. Arbitrazhi sipas këtij Projekti duhet detyrimisht t'i ketë 5 anëtarë. Është një rezolutë e OKB-së për arbitrazhin e cila preferon numër sa më të vogël por palët mund ta bëjnë edhe 5 e shtatë anëtarë, por ajo kushton. Dialogu social neni 85 , nuk munden vetëm përfaqësuesit e punëdhënësve dhe të punëmarrësve të bëjnë kontratën kolektive pasi ajo i referohet Qeverisë se Qeveria është ajo që duhet ta realizonte.

**Teuta Hadri**-Tha se Komisioni ka diskutuar me përfaqësuesit e USAID-it, me përfaqësueset e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe arsyeja e këtij debati është mbledhja e informatave nga të gjithë të interesuarit për dilemat që ka pasur ky Komision. Punëtorët e arsimit dhe të shëndetësisë a do të përfshihen me këtë ligj? Ky ligj a do të jetë bazik edhe për sektorët e tjerë të të punësuarve?

**Edgardo Roggier nga Fondi Monetar Ndërkombëtar**-Tha se besojnë se ligji për punën është shumë i rëndësishëm dhe se Kosova ka nevojë për këtë ligj. Ju si Komision nuk keni përgjigjen e duhur në mënyrë që të bëni vendimin përfundimtar. Është e rëndësishme që të krijoni kushtet për investitorët. Si përfaqësues të njerëzve ju duhet të keni informata për implikimet ekonomike dhe fiskale dhe këto përgjigje nuk mund t'i merrni përderisa nuk keni një vendim bazik për shembull- a përfshihen më këtë ligj edhe punëtorët e arsimit dhe të shëndetësisë apo vetëm sektori privat.

**Ali Dragusha nga Konfederata e Sindikatave të lira të Kosovës** - Tha se fillimisht kamë dy kërkesa, e para që të fuqizohet sa më par ky Ligj dhe çështja tjetër që pas fuqizimit të bëhet zbatimi i ti e të mos ndodh si me kontratën kolektive e cila kurrë nuk është zbatuar.

Mendojmë se me këtë ligj duhet të sanksionohet edhe institucioni i konkursit i cila nuk është i rregulluar me këtë ligj. Të precizojmë format e krijimit të marrëdhënies së punës që janë forma e përhershme dhe forma me kohë të caktuar. Te përgjegjësia disiplinore masa e ndërprerjes së punës nga komisioni disiplinor nuk është e sanksionuar , pra të gjitha ndërprerjet e marrëdhënies së punës i bën punëdhënësi prandaj cila është përgjegjësia e komisionit disiplinor nëse nuk mund ta shqiptoj masën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Këtu kemi edhe dy çështje që masën e largimit të përkohshëm që e bën punëdhënësi dhe çështjen e pezullimit që e bën komisioni disiplinor , këto janë dy qeshje që janë inkompatibile njëra me tjetrën.

Çështje tjetër parimore është edhe dialogu social mendoj se dialogu dhe marrëveshja kolektive duhet të jetë tri paleshe , qeveria , përfaqësuesit e punëdhënësve dhe të punëmarrësve. Qeveria duhet të jetë patjetër e përfshirë . Sa i përket përfshirjes në këtë ligj të shërbimit civil , ligji duhet të jetë bazik për të gjithë të punësuarit në Kosovë dhe kjo çështje nuk duhet të jetë dilemë. Ligjet tjera mund të përfshijnë çështje specifike por ky duhet të jetë një ligj bazik. Në këtë ligj duhet të përfshihet edhe çështja e stazhit të punës, pra përvoja në punë.

**Haxhi Arifi , Kryetar i Bashkimit të Sindikatave të pavarura të Kosovës** - Tha se si BSPK do ti bëjmë me shkrim propozimet tona por ky ligj përveç standardeve ndërkombëtare duhet ti përshtatet edhe kushteve të Kosovës. Në këtë ligj është një mungesë e fjalorit juridik si dhe një mos harmonizim gjuhësor në të tri gjuhët. Në nenin 2 paragrafi 5 te kontrata kolektive do të duhej të ishte e qartë se kontrata kolektive është kontratë në mes të shoqatave

të punëdhënësve dhe organizatave të punëtorëve sepse nuk është e qartë kush është partner social . Duhet çështjet të precizohen dhe jo te ketë dilema. Te neni 3 te shtohet një paragraf i ri ku sindikatat kanë të drejt të konsultohen me aktet interne dhe të reagojnë nëse këto akte janë në kundërshtim me Ligjin e punës dhe Kontratën Kolektive. Te neni 4 paragrafi 3 nuk është i qartë se kush mund te negocioj, sindikatat apo këshilli i punëtorëve . Te neni 6 paragrafi 2 duhet te formulohet me mirë, ku asnjë person nuk duhet te jetë i diskriminuar në asnjë aspekt. Në ligj nuk është fut edhe konventa 81 e Organizatës Ndërkombëtare te Punës pra Konventa e ILO që inspektorati i punës vendoset nën autoritetin qendror . Kërkesa jon është që ky ligj te mos vonohet.

**Shukrie Regjepi përfaqësuese e BSPK- së**-Tha se ligji i punës duhet të jetë bazik dhe të jetë një . Sa i përket implikimeve buxhetore mendoj se punëtoria Kosovare nuk duhet te kthehet ne kërkesat e para 100 viteve, kështu që këto kërkesa nuk janë te kushtueshme janë kërkesa themelore. Pastaj fuqia punëtore në Kosovë është shumë e lirë kështu që ky ligj nuk bën ndonjë pengesë në investimet në Kosovë.

**Ruzhdi Morina – përfaqësues nga Hekurudhat e Kosovës,** tha se duhet të bëhet një ligj sistemor dhe pastaj të nxirren edhe ligje tjera për çështje specifike . Duhet ta kemi një ligj i cili duhet ti përshtatet kushteve të tregut dhe duhet të jetë fleksibil . Ky ligj duhet ta mbroj punëtorin nga punëdhënësi i keq dhe punëdhënësin nga punëtori i keq . Ky ligj ka shumë elemente nga ish sistemi dhe këto duhet të eliminohen . Ne jemi duke paguar kosto te madhe për shkak te mos zbatimit te këtij ligji sepse kemi konteste te mëdha ne gjykata dhe që po zbatohen ligjet e ish Jugosllavisë ku ne po paguam konteste te larta si kompani. Mendoj se ky ligj nuk ka kosto te lart financiare sepse shumë çështje veç ekzistojnë dhe disa çështje të lihen në mundësi. Ky ligj nuk krijon organe të veçanta , inspektorati veç ekziston . Çështja e koston se lehonisë duhet të zgjidhet sepse është një çështje që na prek të gjithëve dhe duhet të bëjmë një zgjidhje të arsyeshme . Sa i përket pajtueshmërisë me ligjet e BE- së ndoshta në kundërshtim të madh nuk është por edhe në pajtim nuk është.

**Asllan Bajrami –** Sindikata e Shëndetësisë së Kosovës tha se do të pyesja sponzoruesin se sa janë marrë parasysh sugjerimet e ekspertëve nga jashtë Kosovës . Sa i përket sektorit të shëndetësisë ne nuk jemi shërbyes civil kjo ka qen për një kohë emergjente por me nuk duhet të jetë, prandaj edhe shëndetësia edhe arsimi duhet patjetër të përfshihen në këtë ligj . Ne kërkojmë ligj të punës i cili do të jetë sa më human dhe të mos i ngulfat as të drejtat e punëdhënësve por gjithmonë duhet të kihet parasysh se kemi të bëjmë me të drejta të fituara dhe nuk hiqet dorë nga të drejtat e fituar në emër të asgjëje. Ky ligj duhet të ketë kujdes edhe sa i përket pushimit të lehonisë , kujdesi ndaj nënës dhe fëmijës duhet të jetë konformë kushteve tona dhe të mos bëjmë eksperimente me nënat tona dhe me pasardhësit tanë.

**Minire Beqaj -** Tha se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që nga viti 2001 ka pas partner social sindikatat dhe oden ekonomike . Që nga viti 2004 kur është marr iniciativa për hartimin e këtij ligji qellim i Qeveris ka qen ligj bërja. Ne pajtohemi që ky ligj të jetë bazik pastaj pas këtij ligji do të kemi edhe disa ligje tjera më specifike. Sa i përket konventave të Organizatës Ndërkombëtare të punës ne jemi mundu që sa është e mundur ti përfshijmë në këtë ligj . Rekomandimet e ILOS të viti 2006 shumicën i kemi përfshi. Si sponsor jemi për një ligj bazik i cili do ti përfshinte të gjithë të punësuarit në Kosovë. Ligji është i standardizuar edhe me konventa edhe me direktiva evropiane . Sa i përket pushimit të lehonisë jemi mundu ta harmonizojmë me konventat e ILOS por edhe me realitetin që ekziston në Kosovë. Kostoja financiare që e ka dhënë ministria jonë ka qenë 6 milion euro dhe buxheti i Kosovës mund ta përballoj.

**Zylfie Hundozi** – Tha se edhe në mandatin e kaluar i kemi pas të njëjtat dilema. Edhe ne mandatin e kaluar kemi pas vërejtje nga Fondi Monetar Ndërkombëtar se ligji është mjaft i kushtueshëm dhe i papërballueshëm nga buxheti i Kosovës i kushtueshëm diku rreth 24 milion euro. Mendimi im është që ky ligj duhet të amendamentohet sa më parë sepse në Kosovë është një legjislacion shumë i komplikuar sa i përket marrëdhënies së punës prandaj Kosova për tu integruar në bashkësinë evropiane që është synim yni duhet që sa më par ta ket ligjin për punën. Dëmshpërblimet që ju paguhen punëtorëve sipas ligjeve të ish Jugosllavisë janë ndoshta më të mëdha sesa shpenzimet që do të bëheshin me këtë ligj. Ligji për shërbyesit civil i punuar nga Ministria e Shërbimeve publike është refuzuar nga Parlamenti në mandatin e kaluar si një ligj keq i punuar . Tani MPMS është dashtë që koston financiare edhe të atij ligji ta përfshij në këtë ligj. MPMS para se ta sjell ligjin në parlament është dashtë të konsultohet me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave dhe me e bë një ekspertizë te mirë financiare .

**Mimoza Ahmetaj** – Tha se ne jemi ne dëgjim publik dhe ti dëgjojmë ekspertet që i kemi thirr. Deputetët për konsulta i kanë mbledhjet e komisioneve.

**Myjezere Mujku** – Tha se në këtë ligj duhet të analizohen dispozitat të cilat lënë hapësirë për dykuptimshmëri apo nuk janë shumë të precizuara si, nenin 16 ku bëhet fjalë për lidhjen e kontratës në kohë të caktuar dhe thuhet se kontrata për kohë të caktuar lidhet në këto raste dhe i numëron rastet ndërsa, në një nen tjetër thuhet se kontrata në kohë të caktuar i lihet punëdhënësi që ta rregulloj me akt të brendshëm. Këto janë disa dilema që nuk duhet të lihen në ligj.

**Sani Berisha përfaqësues i KEK-ut** - Tha se edhe në mandatin e kaluar kemi sjell vërejtjet tona , ndërsa sa i përket dilemave se a duhet të ketë ligj për punën dhe se kush duhet të përfshihet është dashtë të zgjidhen më herët. Kam konkretisht vërejtje në nenin 7 paragrafi 2, te ndalimi i punës së detyrueshme , në fund të fjalisë të shkruhet „ që nuk është e përcaktuar me kontratën e punës’’, në nenin 16 paragrafi 3 fjala „mund të ‘’duhet të fshihet .Te pushimi i lehonisë mendojmë që 6 muajt e parë lehona të paguhet nga punëdhënësi ndërsa 3 muaj të tjerë nga buxheti i Kosovës. Te neni 64 janë të parapara shpërblimet e në veçanti shpërblimet jubilarë është e detyruar kompania ti përmbush vetëm nëse ka afarizëm pozitiv në të kundërtën nuk është i obliguar ti përmbush. Neni 77 largimi i përkohshëm që është 6 muaj duhet të jetë 3. Kërkoj që sa më par të kemi ligjin e aprovuar sepse gjykatat tona çdo dit bien vendime sipas ligjeve të ish Jugosllavisë sa i përket marrëdhënies së punës.

**Sadik Idriz**– Tha se edhe ne jemi që sa më parë të kemi një ligj mirëpo duam që të bëjmë një ligj të mirë dhe të zbatueshëm e jo të ketë një kosto të lart financiare dhe të bllokohet ligji nga Komisioni i Buxhetit.

**Armend Zemaj** – Tha se është bërë një punë në këtë ligj në mandatin e kaluar dhe shumë vërejtje i kemi marrë dhe shumica janë inkorporuar . Siç tha edhe përfaqësuesi USID- it ne duhet ta bëjmë një ligj ku do ti shikojmë edhe favorizimet ekonomike por do te dëshiroja ta dëgjoj mendimin e përfaqësuesit të Fondit Monetar Ndërkombëtar i cili tha se ligj duhet të kthehet prapë në Qeveri , pra a duhet ta hedhim një punë që është bërë qe 4 vjet dhe të fillojmë nga e para. Konkretisht kërkoj mendimin e z. Rogjer se cilat janë çështjet që do ta bëjnë diskriminimin ekonomik dhe çka ne mund të ndryshojmë.

**Qamile Morina** – Tha se jam e zhgënjyer me ecurinë e këtij P/Ligjit . Sot të gjithë jemi unik në qëndrimin ton që sa më par duhet ta kemi një ligj bazik. Mirëpo dilemat tona mbeten të pa sqaruara e ato janë që ky ligj a do të jetë një ligj bazik dhe implikimet e mëdha buxhetore që i ka. Mendoj që ekspertiza financiare nuk ka qenë e mirë në mes të MPMS dhe MEF . Çështjet tjera nuk mendoj që janë aq problematike siç janë këto dy çështje. Kam pyetje për MPMS sa mund të jetë ky ligj i implimentueshëm kur nuk e kemi fondin e sigurimeve shëndetësore?

**Xhevat Shkodra** - Tha që me ligj të mos krijoni mundësi të diskriminohet gjinia femërore sidomos te pushimi i lehonisë.

**Haxhi Arifi** – Tha se jemi këtu që të gjithë të punojmë bashkë dhe ta bëjmë një ligj të mirë. MPMS duhet ta ketë parasysh edhe fjalorin juridik ta fut në ligj nga profesionistët.

**Lumnije Hashani** - OEK tha se kam disa propozime, së pari ku shkruan punëdhënës të paraqitet OEK sepse OEK është e themeluar me ligj dhe në mënyrë ligjore i mbron të drejtat e punëdhënësve . Pastaj te dialogu social , te këshilli konsultativ trepalësh të ndërrohet me emrin këshilli ekonomik social pasi partner social janë Qeveria , OEK dhe BSPK.

**Idajet Berisha** - Tha se Raiffasen Bank ka pas shumë probleme me rregulloren e vjetër të punës sidomos te shkëputja e kontratës e cila nuk ka qenë e rregulluar si duhet. Edhe me këtë ligj nuk po më duket që është e rregulluar mirë kjo çështje dhe përsëri ka me pas probleme. Neni 71 e parasheh që punëdhënësi e shkëput kontratën dhe e thirr punëtorin dhe ja shpjegon arsyet e shkëputjes së kontratës dhe të drejtën e ankesës, ndërsa në nenin 82 ku është komisioni disiplinor bie në kundërshtim me nenin e lartcekur. Mendoj se punëtori të njoftohet me shkrim nëse ka bërë ndonjë shkelje të detyrave të punës . Ne këtë ligj duhet qartë të definohen këto çështje.

**Nyrishahe Hulaj** – Tha se të gjithë po pajtohem për një ligj bazik të punës dhe pas tij mund të nxirren edhe shumë ligje tjera si ligji sindikal , Ligji për shërbyesit civil , Ligji për librezat e punës , Ligji për organizatat publike . Në mandatin e kaluar na është thënë se Ligji për punën nuk mund të implimentohet deri në vitin 2011, prandaj kemi ripunua ligjin dhe kemi zvogëluar koston financiare . Edhe komisioni është që të kemi një ligj bazik prandaj edhe me përkrahjen tuaj ta bëjmë një ligj sa më të mirë dhe të implimentueshëm.

**Edgardo Roggier** – Tha se nëse e shihni nenin 78 i cili është shumë i vështir për një ndërmarrës për tu kuptuar dhe për tu aplikuar dhe krijon shumë kushte për një ndërmarrje që të jetë dinamike. Ka edhe shumë çështje konceptuale . MPMS duhet të krijoj raporte në mes të punëdhënësve dhe punëtorëve.

**Gjylnaze Novobërdaliu-Gola** – Tha se u pajtuam që të kemi një ligj sa më të mirë , ndërsa sa i përket punësimit ne do ta kemi me vonë një ligj për nxitjen e punësimit.

**Sadik Idriz** - pyeti përfaqësuesit e MPMS se a jeni që të kemi një ligj bazik të punës për te gjitha punëtorët e punësuar në Kosovë dhe a keni ndonjë propozim tjetër?

**Gjylnaze Novobërdaliu-Gola** – Tha se pajtohem si Ministri që të kemi një ligj bazik për të gjithë punëtorët por ju jeni ata të cilët do të vendosni .

**Minire Beqaj** – Tha se MPMS koston financiare e ka dhenë diku 10 milion e 900 mijë euro , por pas miratimit të këtij ligji do të vinë diku edhe 10 ligje tjera në pako te gjitha rreth

marrëdhëniet e punës, por së pari ta kemi ligjin bazik të punës. Sa i përket partnerëve social është e precizuar në nenin 86 ku janë tre partner , punëdhënës, punëmarrës dhe Qeveria.

**Hamide Latifi nga shoqata grat për gratë** - Tha se të gjithë po dëshirojmë ta bëjmë një ligj të mirë edhe për punëtor edhe për punëdhënës . Ligji i punës duhet të jetë një ligj bazik. Kontrata e punës duhet të jetë fleksibile dhe jo e përjetshme.

**Zylfie Hundozi** - Tha se pagesat për kujdestari në shëndetësi nuk është dashtë të përfshihen në koston e këtij ligji pasi ato paguhet nga Ministria e Shëndetësisë.

**Sadik Idriz** – Tha se ky debat publik ka dhen rezultatet e pritura edhe pse ka shumë dilema dhe shumë amendamente të propozuara. Do të shohim a do ta angazhojmë edhe një ekspert, do të vazhdojmë kontaktin me MPMS si sponsorues por edhe me sindikatat , me USAID , me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me të gjithë të interesuarit tjerë. Do ta kontaktojmë edhe kryetarin e Komisionit për buxhet por të bëjmë përpjekje të bisedojmë edhe me MEF edhe pse ata nuk po na përgjigjen në kërkesat tona . Amendamente mund të propozojnë të gjithë të interesuarit për këtë ligj. Falënderoj të gjithë për propozimet dhe komentet e dhëna në këtë Projektligj.

Dëgjimi publik përfundoj në ora 13:20 min.

Përgatitur nga  
Zyrtaret e Komisionit

Kryetari i Komisionit

**Sadik Idriz**